

NOTE INFORMUESE

Tiranë, më 7 Qershor 2021

Mbi kërkesën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për pezullim dhe shkarkim nga detyra të magistrates E.K.

Më 30.05.2021, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka filluar me iniciativën e tij, një hetim disiplinor ndaj magistrates E.K., me detyrë Zëvendëskryetare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, njëkohësisht ushtruese e detyrës së Kryetares së kësaj gjykate. Hetimi nisi pas publikimit gjerësisht në median e shkruar, atë vizive dhe në rrjetet sociale, të disa videove, që mbanin logon e rrjetit social “Tik Tok”, ku shfaqej magistratja E.K., në ambientet ku ushtron detyrën dhe brenda një automjeti, me lëvizje e sjellje provokuese, shoqëruar në sfond me muzikë të papërshtatshme për imazhin e një magistrati. Hetimi disiplinor i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë është realizuar në përputhje me afatin 3 ditor të pezullimit të magistratit, në rastin e procedimit disiplinor (neni 152 i ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar).

Nga analiza ligjore e fakteve të konstatuara, si dhe nga dokumentacioni i administruar provohet se:

- Magistratja ka përdorur Zyrën e Kryetarit të Gjykatës, për qëllime të tjera të ndryshme, nga ato që lidhen me ushtrimin e veprimtarisë gjyqësore apo drejtuese të gjykatës.
- Pamjet e videove, kqyrja e të cilave është e dokumentuar edhe në procesverbalet e inspektorëve përgjegjës, konfirmojnë një sjellje totalisht të pahijshme të magistrates, të realizuar me dashje direkte nga ajo vetë, në ditë të ndryshme, në ambiente të ndryshme. Magistratja është vijuese, si në përdorimin e ambienteve të zyrës së kryetarit për të realizuar këto lloj videosh, ashtu edhe në videot e realizuara në automjetin tip BMW.

Nga hetimi disiplinor provohet se nga ana e magistrates E.K. janë shkelur dispozitat lidhur me parimet e integritetit e vetëpërmbytjes:

- Janë shkelur në mënyrë të përsëritur e me dashje “***Parimi i Integritetit***” dhe “***Parimi i sjelljes së hijshme dhe me vetëpërmbytje***”, të parashikuara në Kodin e Etikës Gjyqësore.
- Sjelljet dhe veprimet e magistrates të kryera jashtë ushtrimit të detyrës, por në ambientet e ushtrimit të detyrës, diskretitojnë figurën dhe pozitën e magistratit dhe dëmtojnë besimin e publikut në sistemin gjyqësor, duke u parashikuar si *shkelje shumë e rëndë disiplinore*.
- Videot ku reflektohet sjellja e magistrates kanë marrë edhe jehonë mediatike dhe rasti konkret, u përdor si shembull për etiketimin e sjelljeve negative të anëtarëve të të gjithë gjyqësorit në Shqipëri, përmes raportimeve, analizave e emisioneve të ndryshme.

Në vlerësimin e ILD është themelore se gjyqtari duhet të ruajë dhe zbatojë standarde të larta të sjelljes dhe t’i respektojë personalisht këto standarde, si gjatë ushtrimit të detyrës ashtu edhe në jetën private, në mënyrë që të ruhen integriteti, dinjiteti dhe besimi i qytetarëve tek drejtësia.

Bazuar në konkludimet e hetimit disiplinor, Inspektori i Lartë i Drejtësisë i propozon Këshillit të Lartë Gjyqësor, pezullimin nga detyra të magistrates E.K., deri në përfundimin e procedimit disiplinor dhe masën disiplinore “Shkarkim nga detyra” të parashikuar nga neni 111 i Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

për shkeljet disiplinore të parashikuara nga neni 140, pika 2, shkronja “a” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë”, neni 103, paragrafi 1, shkronja “dh” të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe shkelje të Kodit të Etikës Gjyqësore të miratuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor me Vendimin nr. 171, datë 22.04.2021: Seksionit “C” “Parimi i integritetit”, shkronja “a” dhe “b”, Seksioni “Ç” “Parimi i sjelljes së hijshme dhe me vetëpërmbytje”, pika 9, shkronja “c”.